



Nr. Ref. BD-218/1

Në bazë të neneve 6.1.1, 6.1.2 dhe 15.1 dhe 15.2.3 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenin 5 të Rregullores nr.05-2022 - për përgjegjësitë e Bordit dhe Drejtorit Menaxhues të NSh Inex Sharr Planina në Brezovicë, dhe Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

### VENDIM

- I. Aprovohet dorëheqja e z. Zoran Geric nga pozita u.d. drejtor Menaxhues i NSh Inex Sharr Planina Brezovicë.
- II. Aprovohet shpallja e konkursit publik për emërimin e Drejtorit Menaxhues të NSh Inex Sharr Planina;
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

### ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Menaxhmentit të Agjencisë për aprovimin e dorëheqjes së z. Geric nga pozita u.d. Drejtorit Menaxhues të GJI092 Nsh Inex Sharr Planina në Brezovicë dhe shpalljen e konkursit.

Bordi u bazua në faktin se Drejtori Menaxhues i Nsh Inex Sharr Planina është pozita më e lartë ekzekutive në ndërmarrje dhe bazuar në Rregulloren numër 05/2022 për Përgjegjësitë e Bordit të Përkohshëm dhe Drejtorit Menaxhues të Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina. Bazuar në legjislacionin në fuqi, Drejtori Menaxhues zgjidhet me konkurs publik të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së dhe kohë zgjatja e mandatit të tij përcaktohet me konkurs publik. Me vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-se të mbajtur me date BD-192/1 të datës 14.12.2023 z. Zoran Geric është caktuar të shërbejë në pozitën e u.d. Drejtorit Menaxhues të Ndërmarrjes Inex Sharr Planina. Me këtë vendim nuk i është caktuar mandat i caktuar kohor por Bordi i Agjencisë e ka kushtëzuar që emërimi si u.d. zgjatë deri në finalizimin e konkursit të rekrutimit përmes emërimit të DM të ardhshëm të ndërmarrjes nga Bordi i Agjencisë. Meqenëse kjo nuk është finalizuar ende z. Geric ka mbajtur këtë pozitë deri më tani.


Vendimi personal për dorëheqje nga pozita e ud të Drejtorit Menaxhues z. Zoran Geric është paraqitur në takimin e datës 04.02.2025 në prani të Zyrtareve të DKAD dhe Drejtorit të DKRO. Dorëheqja është dërguar të Bordi i AKP-së me datë 10.02.2025. Dorëheqja sipas z. Geric ka ardhur si pasojë e pakënaqësisë së tij personale për mosrealizimin e planit të punës gjatë ushtrimit të këtij funksioni i cili vlerëson se ka ardhur si pasojë e keqësimit të gjendjes së tij shëndetësore andaj ka kërkuar që ti pranohet kërkesa e parevokueshme për dorëheqje. Duke qenë se pozita mbetet vakante duhet të shpallet konkurs publik për rekrutim.

Duke marrë parasysh të gjitha më lartë, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Këshillë Juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.

  
Mentor Hysoni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit

1 / 1



Nr. Ref. BD-218/2

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrave kadastrale: 1854-0 sipërfaqja e përgjithshme 1955 m<sup>2</sup>; 1855-0 sipërfaqja e përgjithshme 3660 m<sup>2</sup>; 1857-0 sipërfaqja e përgjithshme 7060 m<sup>2</sup>; 1858-1 sipërfaqja e përgjithshme 1811 m<sup>2</sup>; 1864-0 sipërfaqja e përgjithshme 3540 m<sup>2</sup>, ZK Llapnasellë, të gjitha prona të Ndërmarrjes Shoqërore KBI "Kosova Export", me parashtruesin nga fshati Carrabeg i Ulët Deçan.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI "Kosova Export me parashtruesin nga fshati Carrabeg i Ulët Deçan.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë lidhur me paragrafin I të këtij vendimi duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar në faktin sikurse në vijim se dëshiron ti blej këto ngastra kadastrale me qëllim të zgjerimit të aktivitetit të tij. Bordi po ashtu konstatoi se fakt tjetër për refuzim të kërkesës është se parcelat 1854-0; 1855-0; 1857-0; 1858-1 si dhe 1864-0 përveç se nuk kanë ndërtim kanë qasje në rrugë fushore (ngastra 1761-0 PSH rrugët) dhe rrjedhimisht kjo përbën element i cili përjashton iniciimin e procedurës përmes shitjes direkte.

Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.

Mentor Hyseni  
Kryesues

Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-218/3

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes prej 1275 m<sup>2</sup> pjesë e ngastrës kadastrale P-00850-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2100 m<sup>2</sup> ZK Runik, pronë e Kooperativës Bujqësore Runik, Skenderaj me parashtruesin Skenderaj.
- II. Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë rezidenciale ndërsa kategoria është parcelë për shtëpi familjare.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

### ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i inicimit të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Kooperativës Bujqësore Runik, Skenderaj me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore lidhur me kërkesën e parashtruar, Bordi e shqyrtoi në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4.1.2 të Rregullores Nr. 04/2024, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në paragrafi I në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-218/4

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 550 m<sup>2</sup> pjesë e ngastrës kadastrale P-01528-15 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1789 m<sup>2</sup> ZK Prishtinë, pronë e KBI Kosova Export – NSh Bujqësia në Prishtinë, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Bujqësia në Prishtinë, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë lidhur me paragrafin I të këtij vendimi duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores.


Parashtruesi i kërkesës ,kërkesën për shitje direkte e ka bazuar në faktin se gjatë investimeve dhe ndërtimit në kuadër te parcelës se tyre private, ka ndërtuar dhe punuar brenda rrethojave ekzistuese për të cilat, ndërsa më vonë gjatë përfundimit të gjitha punimeve është vërejtur që në të dhënat kadastrale, kanë ndërtuar dhe investuar në një pjesë të ngastrës shoqërore e cila menaxhohet nga AKP. Bordi konstatoi se në bazë të Certifikatës pronësore kjo parcelë kategorizohet si Infrastruktural me shfrytëzim aktual “Rrugë”.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar Agjencia nuk shet rrugë, pasi që në regjistrat pronësor tipi i pronës është rrugë dhe nga ky argument kemi konkludimin se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte, Bordi në argumentim të vendimit kishte për bazë dhe rrethanën se gjendja aktuale e ngastrës krijon mundësinë që si e tillë të shfrytëzohet për interes publik. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-218/5

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje direkte për pjesën 21 m<sup>2</sup> të parcelës kadastrale: Nr. P-71914050-00821-0 Sipërfaqja e parcelës 390 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale: Matiçan, Komuna: Prishtinë në pronësi të ndërmarrjes Shoqërore KBI Kosova Export "Ratar" me parashtruesin
- II. Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë rezidenciale ndërsa kategoria është parcelë për ndërtesë apartamentesh
- III. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte për pjesën 369 m<sup>2</sup> të parcelës kadastrale: Nr. P-71914050-00821-0 Sipërfaqja e parcelës 390 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale: Matiçan, Komuna: Prishtinë në pronësi të ndërmarrjes Shoqërore KBI Kosova Export "Ratar" me parashtruesin
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

### ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa e palës për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e KBI Kosova Export "Ratar" me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë lidhur në paragrafët I dhe II të këtij vendimi, Bordi konstatoi se rasti për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4.1.2 të Rregullores Nr. 04/2024.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë lidhur në paragrafin III të këtij vendimi Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se ngastrën në fialë e ka në fqinjësi me ngastrat e tij dhe i duhet për realizimin e projektit ndërtimor sipas planit për . Sa i përket pjesës 369 m<sup>2</sup> të parcelës kadastrale: Nr. P-71914050-00821-0 Sipërfaqja e përgjithshme parcelës 390 m<sup>2</sup>, Bordi konstatoi se sipas ekspertizës dhe pamjeve në gjeoportali në këtë pjesë nuk ka ndërtim dhe poashtu pas parasysh kërkesën e palës që parcelat janë në fqinjësi - konstatoi se nuk ka bazë të mjaftueshme juridike për iniciimin e procedurës për shitje direkte.

Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:


Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org)

[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



**Mentor Hyseni**  
**Kryesues**  
**Bordi i Drejtorëve**  
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**





Nr. Ref. BD-218/6

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte për pjesën 110 m<sup>2</sup> të parcelës kadastrale: Nr. P-71914050-00821-0 Sipërfaqja e parcelës 390 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale: Matiçan, Komuna: Prishtinë në pronësi të NSh KBI Kosova Export "Ratar" me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

### ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Kosova Export "Ratar" me parashtruesin.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë lidhur me dispozitivin e këtij vendimi duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se kërkesa nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores.

Pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se parcela 00821-0 kufizohet me parcelën kadastrale 00824-12, e cila është në pronësi të tij në të cilën ka të ndërtuar shtëpinë ku edhe jeton. Gjate shqyrtimit të kësaj çështje Bordi shqyrtoi dhe gjendjen faktike, ku konstatoi se një pjesë e oborrit shtrihet në parcelën e NSh-së e cila është edhe objekt i kërkesës. Pala ne argumentim të kërkesës se saj me tutje deklaroi se ai është në posedim të pa penguar tash e sa vite dhe e shfrytëzon si pjesë integrale e pronës së tij private. Bordi konkludoi se sipas ekspertizës dhe pamjeve në gjeoportali në pjesën 110 m<sup>2</sup> nuk ka ndërtim dhe po ashtu pas parasysh kërkesën e palës që parcelat janë në fqinjësi - konstatoi se nuk ka bazë të mjaftueshme juridike për iniciimin e procedurës për shitje direkte.

Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-218/7

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale P-02231-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 15990 m<sup>2</sup> ZK Vushtrri, pronë e NSh ELAN në Vushtrri, me parashtruesin nga Vushtrria.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh ELAN në Vushtrri, me parashtruesin nga Vushtrria.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm deklaratën e tij të shprehur në kërkesë e qe ne kërkesë pala ka theksuar se kërkon që të blejë përmes shitjes direkte ngastrën kadastrale P-02231-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 15990 m<sup>2</sup> ZK Vushtrri pronë e NSh ELAN në Vushtrri.

Në kërkesën e parashtruar, është theksuar se qëllimi i kërkesës së tillë, për blerjen e kësaj ngastre kadastrale 02231-0 është planifikimi për zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit biznesor, duke bërë investime në vlerë e cila kalon 1 milion euro dhe krijimi i vendeve të reja të punës.

Pala në mbështetje të kërkesës së tij nuk ka paraqitur ekspertizën gjeodezike, përveç se një ortofoto të marrë nga Gjeoportali i Kosovës si dhe disa fotografi të pjesës së ngastrës kadastrale. Ne shtjellim te kësaj çështje juridike agjencia ka konstatuar se parcela kadastrale që është objekt i kërkesës gjendet në zonën kadastrale në Vushtrri në Komunën e Vushtrrisë dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme biznesi. Në pronë aktualisht sipas pamjeve të gjeoportalit shihet se ka objekte të vjetra ekzistuese të NSh-së dhe e njëjta në të tri anët e saj ka qasje në rrugë publike, konkretisht njëra pjesë e saj ka qasje në magjistralen Vushtrri – Mitrovicë.

Bordi gjate shqyrtimit te kërkesës se parashtruar kishte pasur parasysh faktin se ngastra kadastrale që është objekt i kërkesës ka qasje të pa penguar nëpër rrugë publike dhe se objektet të cilat janë aktualisht në ngastër nuk kanë asnjë ndërlidhje me parashtruesin e kërkesës. Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.







AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.  
Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi / Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-218/8

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale P-01262-2 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1702 m<sup>2</sup> ZK Mitrovicë pronë e BIP Beograd me parashtruesin**

**II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e MIT139 BIP Beograd me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës së tij pala ka theksuar se këtë ngastër e cila është objekt i kërkesës me sipërfaqe te përgjithshme 1702 m<sup>2</sup> si dhe dy objekte te ndërtuara mbi këtë ngastër (objekte te NSH-së) me sipërfaqe prej 546.8m<sup>2</sup> .

Parashtruesi i kërkesës deklaroi se pronën ceshtje e vendosjes e ka ne shfrytëzim prej vitit 1999 që nga paslufta dhe të njëjtat i ka shfrytëzuar në vazhdimësi pa penguar nga askush. Ngastren dhe objektet përcjellëse i ka ne shfrytëzim mbi bazën e kontratës mbi qiranë të lidhur mes AKP-së dhe në cilësinë e qiramarrësit. Përveç tjerash pala ka theksuar se dy objekte e NSH-se të cilat kane qenë në ngastren 1262/2 me mjete vetanake i ka rinovuar sepse kane qenë pothuajse tërësisht të demoluara dhe nuk i kane plotësuar kushtet minimale për të ushtruar aktivitetin biznesor dhe se investimet e bëra sipas palës kapin një shumë të konsiderueshme të mjeteve lidhur me këto investime.

Në fillim të vitit 2019, duke ju përshtatur tregut dhe konkurrencës pala ka deklaruar se ka qenë i detyruar që mbi këtë ngastër të ndërtojë objektin me etazhitet P+0 me sipërfaqe prej 98.44m<sup>2</sup> për qëllim të biznesit, pasi që objektet ekzistuese në pronësi te NSH-se kane qene të pa mjaftueshme për të zhvilluar normalisht aktivitetin e përditshëm biznesor. Pala në mbështetje të kërkesës së tij ka paraqitur ekspertizën gjeodezike, ne baze të të cilës i ka përshkruar matjet e ngastrës dhe pretendimet e tij lidhur me këtë ngastër.

Parcela kadastrale që është objekt i kërkesës gjendet në ZK Mitrovicë në Komunën e Mitrovicës dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme biznesi. Në pronë aktualisht sipas pamjeve të gjeoportalit shihet se ka objekte të vjetra ekzistuese të NSH-së dhe parcela ka qasje direkte të pa penguar në rrugë publike.






Bordi ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës dhe ka konstatuar se rasti nuk mund të bie në kategorinë e asetit specifik në përputhje me dispozita ligjore të Rregullores 04/2024 për Shitje Direkte, për faktin se ngastra kadastrale ka qasje direkte të pa penguar në rrugë publike dhe poashtu për faktin se objekti prej 98m<sup>2</sup> i cili është ndërtuar nga pala në vitin 2019 për nevoja të biznesit të tij dhe i njëjti nuk mund të përfshihet në procesin e shitjes direkte për faktin se sipas nenit 4 paragrafit 1.2 të rregullores 04/2024 për Shitje Direkte në të cilin ndër tjera është theksuar se ... *Ndërtimet e realizuara, të cilat nuk janë të dukshme në aero incizimet e vitit 2018, kur në territorin e Kosovës është zbatuar incizimi i fundit aerofotogrametik, nuk do të përfshihen në procesin e shitjes direkte.*

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.  
Prishtinë, më 14 shkurt 2025.

  
**Mentor Hyseni**  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-218/9

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P-05514-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2386 m<sup>2</sup> ZK Vërbeshticë pronë e SHARR Pllanina INEX në Shtërpcë me parashtruesin  
- Ramiz Sadiku SH.P.K nga Prishtina
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh SHARR Pllanina INEX në Shtërpcë me parashtruesin  
- Ramiz Sadiku SH.P.K. nga Prishtina

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës së tij pala ka theksuar se në vitin 2006 përmes tenderit publik ka privatizuar ndërmarrjen Ramiz Sadiku dhe në këtë drejtim në kuadër të kësaj parcele për të cilën ka parashtruar kërkesë kanë qenë sendet e luajtshme sikurse është baza e betonit dhe një pjesë e barakave te cilat sipas palës janë privatizuar nga AKM ne vitin 2006.


Tutje pala ka deklaruar se qe nga ajo kohe kjo parcelë ka qenë ne shfrytëzim te tij qysh prej 16 vitesh. Pala në mbështetje të kërkesës së tij nuk ka paraqitur ekspertizën gjeodezike, përveç se një ortofoto të marrë nga Gjeoportali i Kosovës si dhe disa fotografi të pjesës së ngastrës kadastrale.

Parcela kadastrale që është objekt i kërkesës gjendet në zonën kadastrale në Vërbeshticë në Komunën e Shtërpcës dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë e ndryshme biznesi. Në pronë aktualisht sipas pamjeve të gjeoportalit shihet se ka objekte të vjetra ekzistuese të NSh-së dhe e njëjta ka qasje direkte në rrugë publike

Bordi ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës dhe ka konstatuar se rasti nuk bie në kategorinë e asetit specifik për faktin se ngastra kadastrale ka qasje të pa penguar nëpër rrugë publike dhe se objektet të cilat aktualisht në ngastër nuk kanë asnjë ndërlidhje me parashtruesin e kërkesës.

Po ashtu, pretendimi i palës se i njëjti dëshiron ta blejë këtë ngastër kadastrale pasi qe ka privatizuar ndërmarrjen Ramiz Sadiku dhe në këtë drejtim në kuadër te kësaj parcele për te cilën ka parashtruar kërkesë kane qene sendet e luajtshme sikurse është baza e betonit dhe një pjese e barakave të cilat ne i kemi privatizuar nga AKM në vitin 2006 nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast.





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



  
Mentor Hyseni

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-218/10

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

### I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrave kadastrale:

- 1119-2, sipërfaqja e përgjithshme 3835 m<sup>2</sup>
- 1119-3, sipërfaqja e përgjithshme 1566 m<sup>2</sup>
- 1119-4, sipërfaqja e përgjithshme 6988 m<sup>2</sup>
- 1119-5, sipërfaqja e përgjithshme 2992 m<sup>2</sup>
- 1119-7, sipërfaqja e përgjithshme 10663 m<sup>2</sup>
- Total 26044 m<sup>2</sup>

Zona Kadastrale Dobratin, Komuna Graçanicë. Të gjitha prona të Ndërmarrjes Shoqërore nga Prishtina.  
Kooperativa Bujqësore e Kosovës me parashtuesin

### II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSH Kooperativa Bujqësore e Kosovës me parashtuesin nga Prishtina.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës së tij pala ka theksuar se përballë ngastrave kadastrale të cilat janë objekt i kërkesës, kjo kompani zotëron dy parcela me 1978-2 dhe 1978-1 ZK Dobratin. Në këto parcela kompania është duke ndërtuar objektin afarist të natyrës industriale të cilin objekt e ndërton sipas lejes së lëshuar nga Komuna e Graçanicës, dhe rrjedhimisht zgjerimi i hapësirës operuese momentalisht është esencial për operimin e mirëfilltë, e që njëje rit është edhe arsyetimi në kërkesën e parashtuar tek AKP.

Pala në mbështetje të kërkesës së tij ka paraqitur edhe ekspertizën gjeodezike, përmes së cilës është theksuar se parashtuesi i kërkesës ka dy njësi kadastrale të cilat janë në pronësi të Kompanisë dhe të njëjtat gjenden përballë me parcelat të cilat janë objekt i kërkesës për blerje direkte dhe se për qëllim të zgjerimit të aktivitetit të tij dëshiron t'i blej edhe parcelat kadastrale të precizuara në kërkesë. Sipas kësaj ekspertize gjeodezike të gjitha këto ngastra kadastrale janë të ngjitura njëra me tjetrën dhe të njëjtat shfrytëzohen si tokë bujqësore nga palë të tjera. Parcelat që janë objekt i kërkesës gjenden në ZK në Dobratin në Komunën e Graçanicës dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme bujqësore. Në këto prona aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim.





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte pasi që në pronën në fjalë nuk ka ndërtim. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-218/11

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrave kadastrale:
- 1822-0, sipërfaqja e përgjithshme 8101 m<sup>2</sup>
  - 1823-0, sipërfaqja e përgjithshme 3148 m<sup>2</sup>
  - 1825-0, sipërfaqja e përgjithshme 3439 m<sup>2</sup>
  - 1834-2, sipërfaqja e përgjithshme 3619 m<sup>2</sup>
- ZK Llapnasellë, të gjitha prona të NSh KBI "Kosova Export", me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI "Kosova Export", me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të NSh.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesës e vet e ka bazuar vetëm në faktin se ka disa njësi kadastrale të cilat janë në pronësi të tij private dhe të njëjtat kufizohen me parcelat të cilat janë objekt i kërkesës për blerje direkte dhe se për qëllim të zgjerimit të aktivitetit të tij dëshiron t'i blejë edhe parcelat kadastrale të precizuara në kërkesë. Pala në mbështetje të kërkesës së tij ka paraqitur edhe ekspertizën gjeodezike. Parcelat që janë objekt i kërkesës gjenden në ZK Llapnasellë në Komunën e Graçanicës dhe kanë një pozitë shumë të përshatshme për veprimtaritë të ndryshme bujqësore. Në pronë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe e njëjta ka qasje në rrugë fushore. Rruga ku parcelat kanë qasje evidentohet me nr 1942-0 dhe atë në emër të PSH RRUGËT.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se pasi që nuk ka ndërtim dhe parcela e NSh-së ka qasje në rrugë nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.  
Prishtinë, më 14 shkurt 2025.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-218/12

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrave kadastrale si në vijim:
- 00988-4, sipërfaqja e përgjithshme 1076 m<sup>2</sup>
  - 00972-3, sipërfaqja e përgjithshme 1484 m<sup>2</sup>
  - 00989-1, sipërfaqja e përgjithshme 2057 m<sup>2</sup>
- ZK Lubizhdë, të gjitha pronë e NSh KBI Progres, Prizren me parashtruesin \_\_\_\_\_ nga Prizreni.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, Prizren me parashtruesin \_\_\_\_\_ nga Prizreni.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të NSh.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se si prodhues vendor është në proces të zgjerimit të biznesit si Fabrikë konditorike për prodhimin e bonboneve, ëmbëlsirave etj dhe ka kërkuar nga AKP që ti mundësojë blerjen e ngastrave të lartcekura përmes shitjes direkte duke qenë se me rritjen e kapaciteteve prodhuese është e domosdoshme zgjerimi i biznesit.

Pala në mbështetje të kërkesës nuk ka bashkangjitur ndonjë ekspertizën gjeodezike për të elaboruar me saktësi pretendimet e tij, përveç se ka bashkangjitur ortofoto nga gjeoportali i Kosovës si dhe disa fotografi të ngastrave në fjalë.

Parcelat që janë objekt i kërkesës gjendet në ZK Lubizhdë në Komunën e Prizrenit dhe kanë një pozitë shumë të përshatshme për veprimtaritë të ndryshme si bujqësore dhe po ashtu edhe biznesi me aktivitete të ndryshme pasi që është një zonë ku zhvillohen aktivitet të ndryshme biznesore. Në këtë pjesë të parcelës së kërkuar nga pala aktualisht sipas ortofotos se dorëzuar nga pala dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim. Ashtu sikurse shihet edhe në gjeoportali Komuna e Prizrenit në këtë zonë ka hartuar edhe planin rregullues ku dhe të njëjtat do të kenë qasje të pa penguar në rrugë ashtu sikurse është paraparë në planin rregullues.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se pasi që nuk ka ndërtim dhe parcela e NSh-së do të ketë qasje në rrugë sipas Planit rregullues të Komunës - nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



Mentor Hyseni

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-218/13

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrave kadastrale  
01330-0, sipërfaqja e përgjithshme 27729 m<sup>2</sup>  
01329-0, sipërfaqja e përgjithshme 385 m<sup>2</sup>  
ZK Stubëll e Epërme, të gjitha pronë e NSh Agromorava në Viti me parashtruesin nga fshati Stubëll.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Agromorava në Viti me parashtruesin nga fshati Stubëll.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të NSh.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se dëshiron ti blej ngastrat me qëllim për rregullimin e Parkut dhe ndërtimin e Qendrës për të rinjtë e fshatit Stubëll e Epërme (investim për park rini dhe sport). Në kërkesë nuk është dhënë asnjë arsytim apo përshkrim tjetër lidhur me këtë pretendim. Pala në mbështetje të kërkesës nuk ka bashkangjitur ndonjë ekspertizë gjeodezike për të elaboruar me saktësi pretendimet e tij, përveç një ortofotoje nga gjeoportali i Kosovës si dhe kopjen e planit lidhur me këto ngastra. Parcela e cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Stubëll e Epërme në Komunën e Vitisë dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme si bujqësore dhe po ashtu edhe biznesi me aktivitete të ndryshme dhe e njëjta ka në sipërfaqe të madhe prej 2.7 HA e cila gjendet pothuajse në mesin e fshatit Stubëll. Sipas ortofotos se dorëzuar nga pala dhe pamjeve të gjeoportalit parcela ka qasje nëpër rrugë, në fakt rruga e emëruar Anton Qeta kalon në këtë ngastër dhe në të shihet se ka disa ndërtime mirëpo nuk janë në posedim apo shfrytëzim të parashtruesit të kërkesës. Agjencia ka disa kërkesa tjera të disa personave fizik lidhur me pjesë të kësaj ngastre.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se pasi që nuk ka ndërtim dhe se kërkesa e palës për rregullimin e Parkut dhe ndërtimin e Qendrës për të rinjtë e fshatit Stubëll e Epërme - nuk është bazë emjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



Mentor Hyseni

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-218/14

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelave sin ë vijim:  
01330-0, sipërfaqja e përgjithshme 27729 m<sup>2</sup>  
01329-0, sipërfaqja e përgjithshme 385 m<sup>2</sup>  
ZK Stubëll e Epërme, të gjitha pronë e NSH Agromorava në Viti me parashtruesin nga fshati Stubëll.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSH Agromorava në Viti me parashtruesin nga fshati Stubëll.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të NSH.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se se dëshiron ti blej ngastrat me qëllim për rregullimin e Parkut te Stubllës si dhe parkingut për vetura.

Në kërkesë nuk është dhënë asnjë arsyetim apo përshkrim tjetër lidhur me këtë pretendim. Pala në mbështetje të kërkesës nuk ka bashkangjitur ndonjë ekspertizën gjeodezike për te elaboruar me saktësi pretendimet e tij, përveç një ortofotoje nga gjeoportali i Kosovës si dhe kopjen e planit lidhur me këto ngastra. Parcela e cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Stubëll e Epërme në Komunën e Vitisë dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme si bujqësore dhe po ashtu edhe biznesi me aktivitete te ndryshme dhe e njëjta ka ne sipërfaqe te madhe prej 2.7 ha e cila gjendet pothuajse ne mesin e fshatit Stubëll.

Sipas ortofotos se dorëzuar nga pala dhe pamjeve të gjeoportalit parcelat e sipër cekura kanë qasje nëpër rrugë, në faktë rruga e emëruar Anton Qeta kalon në këtë ngastër dhe në të shihet se ka disa ndërtime mirëpo nuk janë në posedim apo shfrytëzim te parashtruesit te kërkesës. Agjencia ka disa kërkesa tjera të personave fizik lidhur me pjese të kësaj ngastre.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se pasi që nuk ka ndërtim dhe sekërkesa e palës për rregullimin e Parkut dhe parkingut për vetura - nuk është bazë e mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.

  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-218/15

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

### V E N D I M

1. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale 00224-1, me sipërfaqe të përgjithshme 1119 m<sup>2</sup> ZK Bablak, pronë e NSh Pasuria Bujqësore në Ferizaj me parashtruesin nga Kaçaniku.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

### ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Pasuria Bujqësore në Ferizaj me parashtruesin nga Kaçaniku.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të NSh.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës së tij pala thekson se është shfrytëzues i pronës në sipërfaqe prej 1119m<sup>2</sup> narcelë e cila sipas regjistrit kadastral evidentohet si kulturë Arrë e klasit 3. Në këtë pjesë të parcelës pretendon ta shfrytëzoj si hapësirë vazhdimi në palujtshërinë e saj.

Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur edhe ekspertizën gjeodezike duke përshkruar pretendimet e tij lidhur me këtë ngastër kadastrale. Sipërfaqja e parcelës nr.224-1 është 1119m<sup>2</sup>, përderisa pjesa grafike e kësaj parcele nuk është azhurnuar.

Parcela kadastrale e cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Bablak në Komunën e Ferizajt dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme biznesi. Në këtë ngastër kadastrale të kërkuar nga pala aktualisht sipas ortofotos se dorëzuar nga pala dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim, përveç se një pjesë e disa mureve të separacionit që është zhvilluar aktivitetet i njëjtë në këtë ngastër më herët. Parcela ka qasje në direkte në rrugë fushore. Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se pasi që nuk ka ndërtim dhe si ka qasje në direkte në rrugë fushore - nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.  
Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



Mentor Hyseni  
Kryesues

Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-218/16

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të të parcelave si në vijim:  
00864-0, sipërfaqja e përgjithshme 6894 m<sup>2</sup>  
00866-0, sipërfaqja e përgjithshme 1649 m<sup>2</sup>  
00868-0, sipërfaqja e përgjithshme 1698 m<sup>2</sup>  
00870-0, sipërfaqja e përgjithshme 5395 m<sup>2</sup>  
ZK Lubizhdë, të gjitha pronë e NSh KBI Progres me parashtruesin nga Prizreni.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të NSh.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës së tij pala thekson se si prodhues vendor është në proces të zgjerimit të biznesit si Fabrikë për prodhimin e dyerve dritareve, kuzhinave dhe elementeve përcjellëse nga druri dhe i njëjti ka kërkuar nga Agjencia që ti mundësojë blerjen e ngastrave te lartcekura përmes shitjes direkte.

Pala tutje ka deklaruar se me rritjen e kapaciteteve prodhuese është e domosdoshme zgjerimi dhe si rrjedhojë ka lindur kërkesa për blerjen e këtyre asetëve përmes shitjes direkte, pasi qe ashtu sikurse ka deklaruar pala në kërkesë kjo do te ndikojë në rritjen e stafit dhe zbutjen e papunësisë në vendin tonë. Pala në mbështetje të kërkesës nuk ka bashkangjitur ndonjë ekspertizën gjeodezike për te elaboruar me saktësi pretendimet e tij, përveç një ortofotoje nga gjeoportali i Kosovës si dhe disa fotografi të ngastrave në fjalë.

Parcelat kadastrale të cilat janë objekt i kërkesës gjendet në ZK Lubizhdë në Komunën e Prizrenit dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme si bujqësore dhe po ashtu edhe biznesi me aktivitete te ndryshme pasi qe është një zonë ku zhvillohen aktivitete të ndryshme biznesore. Agjencia konstatoi faktin se në këto parcela sipas ortofotos se dorëzuar nga pala dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim. Këto ngastra e rrethojnë pronën e kompanisë e cila ka të ndërtuar objektin (në pronën e tij private) dhe i njëjti është i rrethuar me mur te lartë rrethues.






AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se pasi që nuk ka ndërtim dhe nuk ka bazë të mjaftueshme për inicimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-218/17

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të objektit i evidentuar në njësinë me numër kadastral 1614-0-73-0 me sipërfaqe prej 40.90 m<sup>2</sup> pronë e NSh Bankos, ZK Kamenicë me parashtruesin nga Kamenica.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

### ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Bankos, ZK Kamenicë me parashtruesin nga Kamenica.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të NSh.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës së tij pala thekson se e shfrytëzon objektin në pronësi të NSh Bankos me vite të tera nëpërmjet kontratës së qirasë të nënshkruar nga AL i NSh Bankos. Sipërfaqja e cila shfrytëzohet sipas kontratës së qirasë është 40.90m<sup>2</sup>.

Sipas deklaratës së palës përgjatë viteve të shfrytëzimit të objektit janë bërë investime të theksuara me çast është rritur sipërfaqja e asetit dhe po ashtu edhe vlera e saj. Tutje pala ka theksuar se nga dita kur është marrë në shfrytëzim ky aset, janë paguar rreth 20,000 euro në emër të ndërmarrjes duke shtuar edhe vlerën e investimeve që sillen rreth 50,000 euro, dhe si rrjedhojë e kësaj pala pretendon se kërkesa ka bazë të mjaftueshme si në aspektin teknik e faktik po ashtu edhe në atë juridik për iniciimin e procesit të shitjes direkte.

Në mbështetje të kërkesës pala ka paraqitur edhe ekspertizën gjeodezike duke elaboruar pretendimet e tij lidhur me objektin/lokalin. Sipas përshkrimit të dhënë ne ekspertizën gjeodezike lokalit me sipërfaqe prej 40.90m<sup>2</sup> gjendet në sheshin e Komunës së Kamenicës ne objektin nr.1614-0-73-0 kati përdhese me pamje nga lindja. Lokali si pjesë e ndërtesës nuk është i regjistruar me numër të veçantë. në Drejtorin e gjeodezisë dhe kadastrit ne komunën e Kamenicës

Parcela kadastrale 1614-0 së bashku me njësinë kadastrale 1614-0-73-0 e cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Kamenicë në Komunën e Kamenicës, konkretisht në pjesën qendrore të qytetit në sheshin e komunës.

Lokali gjendet në katin përdhese të ndërtesës kolektive/ njësi banesore, dhe i njëjti është me qasje direkte ne rrugë dhe në një pjesë atraktive të qytetit të Podujevës. Bordi konstaton se investimet janë bërë në dobi të zhvillimit të aktivitetit të tij biznesor. Prandaj pretendimi i palës se i njëjti është dëshiron ta blejë këtë





aset/lokal afarist përmes shitjes direkte sepse ka bërë shumë të konsiderueshme te investimeve ne te nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast. Poashtu edhe sipas dispozitave të Rregullores për qiradhënie dhe kontratës së qiradhënies pala duhet të kërkoj leje nga Agjencia për çfarëdo ndryshimi në strukturë të lokalit, investime apo ndërrim i qiramarrësit.

Rregullorja Nr. 4/2024, për shitjen direkte të asetëve të caktuara të ndërmarrjeve shoqërore, nuk i njeh shpenzimet dhe/ose veprimet e tilla, të palejuara më parë dhe për interesa të parashtruesit të kërkesës, si bazë për iniciimin e shitjes direkte.


Sipas Ligjit mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, e drejta e pronësisë është e drejtë reale me karakter absolut, nga e cila nuk mund të privohet asnjë pronar, përfshirë dhe NSH-të, pavarësisht ndonjë renovimi eventual. AKP ka parasysh faktet si më sipër, sepse me ligj i është adresuar përgjegjësia ekskluzive për administrimin dhe ruajtjen e të gjitha pasurive të NSH, për interesa të punëtorëve dhe kreditorëve eventual.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



Mentor Hyseni  
Kryesues

Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-218/18

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelave në vijim:
- 1363 m<sup>2</sup> nga ngastra kadastrale 07498-0, sipërfaqja e përgjithshme 3018 m<sup>2</sup>
  - 2590 m<sup>2</sup> nga ngastra kadastrale 07497-0, sipërfaqja e përgjithshme 5140 m<sup>2</sup>
  - 127 m<sup>2</sup> nga ngastra kadastrale 07662-17, sipërfaqja e përgjithshme 125767 m<sup>2</sup>
- ZK Prishtinë, pronë e NSh Magjistranja me parashtruesin

- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Magjistranja me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të NSh-së. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës së tij pala thekson se të njëjtat i shfrytëzon për nevoja te biznesit që nga datat 10.08.2002 e deri më tani mbi bazën e kontratës se qirasë, fillimisht me ndërmarrjen SH.A Magjistranja, me pas me AKM dhe tani me AKP-në.

Me datën 02.09.2002 SH.A Magjistranja (qiradhënësi) me seli ne Prishtine dhe Kompania

(Qiramarrësi) me seli në Ferizaj kanë lidhur kontrate qiraje për dhënien e objektit me qira (neni 1 i kontratës: Përshkrimi i objekti te dhënë me qira), ku objekt i kësaj kontrate të qirasë ka qenë një depo dhe oborri i saj, pronë e qiradhënësit, e cila gjendet ne rrugën Prishtinë-Fushe Kosovë. Sipas kësaj kontrate "Depoja" ka sipërfaqen 1200m2 dhe është e ndërtuar me material montazh i kombinuar dru-shtylla metali dhe llamarinë. Dyshemeja e depos është e shtruar me beton, përderisa oborri i depos ka sipërfaqe 1900m2 dhe pjesën e përparme frontale kufizohet me rrugën Prishtine Fushe Kosovë, përderisa mbrapa saj me vijën hekurudhore Prishtine-Fushe Kosovë. Objekti do të përdoret si objekt afarist për shitjen e mallit te qiramarrësit. Afati i kontratës 10 vite.

Në nenin 5.2 te kësaj kontrate është theksuar se pas skadimit të kësaj kontrate palët kontraktuese do të krijojnë një komision te përbashkët i cili do të vlerësoj adaptimet dhe meremetimet e bëra nga qiramarrësi në objekt të cilat nuk mund te largohen nga objekti. Ne nenin 5.3 është theksuar se shuma përcaktuar nga komisioni si investim nga qiramarrësi ne objekt do te kompensohet nga ana e qiradhënësit.

Në anën tjetër me hyrjen në procesin e likuidimit të NSh Magjistrala në vitin 2017 është lidhur kontratë e re e qirasë në mes NSh Magjistranja (ne likuidim) dhe NTP "

*M.A.*





Në nenin 2 (Shfrytëzimi i lokaleve afariste) përkatësisht në nenet 2.6.1; 2.6.2 dhe 2.6.3 është përshkruar se çfarëdo ndryshime apo shtesa nga qiramarrësi në lokalet afariste për të cilat si është marre pëlqim paraprak si kur nuk është marre pëlqim paraprak nga AKP dhe të cilat nuk mund të hiqen pa shkaktuar dëmtime në lokalet afariste, pas përfundimit të kësaj kontrate të qirasë nuk do të kompensohen në çfarëdo mënyrë nga qiradhënësi, AKP apo çfarëdo pale e tretë.

Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur edhe ekspertizën gjeodezike duke elaboruar pretendimet e tij. Sipas kësaj ekspertize parcelat në të cilat shtrihet objekti dhe hapësirat e oborrit që shfrytëzohen për parking të veturave janë në pronësi të pronareve të ndryshëm.

Parcela kadastrale e cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Prishtinë në Komunën e Prishtinës. Në këtë pjesë të parcelës së kërkuar nga pala aktualisht sipas ortofotos se dorëzuar nga pala dhe pamjeve të gjeoportalit ekziston objekti afaristë për të cilin është bere kërkesa për blerje dirkete se bashku me sipërfaqen tokësore të kërkuar. Mbi këtë objekt dhe ngastrat të cilat janë objekt kërkesës gjendet një infrastrukturë kryqe publike rrugore sikurse është rreh-rrotullimi kryesor i hyrjes në qytetin e Prishtinës si dhe afër lokalit afariste është edhe hekurudha dhe po ashtu në këto pjesë është duke u ndërtuar edhe infrastrukturë e re rrugore.

Pretendimi i palës se i njëjta është dëshiron ti blej këto ngastra pasi që sikurse ka deklaruar në kërkesë të njëjtat i shfrytëzon për nevoja të biznesit që nga datat 10.08.2002 e deri më tani mbi bazën e kontratës së qirasë nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast.

Po ashtu, këtu kemi të bëjmë edhe me objekt afarist ekzistues të NSh-së (është përshkruar në kontratën e qirasë të vitit 2002) i cili si i tillë nuk mund të përfshihet në kategorinë e asetit për shtje me karakter specifik dhe po ashtu i njëjti i është dhënë me qira fillimisht nga NSh-ja e me pastaj nga AKP-ja, në të cilin janë specifikuar në detaje çështja e investimeve të bëra në të se nuk do të kompensohen në çfarëdo mënyrë nga qiradhënësi, AKP apo çfarëdo pale e tretë.


Në anën tjetër, ashtu sikurse është përshkruar edhe në ekspertizën gjeodezike disa nga ngastrat të cilat janë objekt i kërkesës nuk evidentohen as në emër të NSh-së sikurse është ngastra 7662-17 e cila evidentohet në emër të Hekurudhave të Kosovës, tani ngastra 7498-0 e cila evidentohet në emër të PSh Rrugët – në të cilin gjendet edhe pjesa më e madhe e objektit. Agjencia nuk ka mandat që të merret me trajtimin e tyre..


Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



  
Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-218/19

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale 00281-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 390 m<sup>2</sup>, ZK Matičan, pronë e NSh-së “Kosova Export”, me parashtruesin nga Prishtina.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

### ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh “Kosova Export”, me parashtruesin nga Prishtina.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të NSh-së.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij pala thekson se kërkesa e tij bazohet kryesisht për faktin se prona e tij kufizohet me këtë parcelë. Pala deklaroi se kërkesa e tij për blerje direkte është në përputhje me ligjet e AKP-së.

Pala në mbështetje të kërkesës pala ka dorëzuar elaboratin gjeodezike për parcelën kadastrale 00821-0, së bashku me skica dhe ortofoto, si dhe kopjet e planit për ngastrat 00824-20, 00824-22, 00826-13, të cilat evidentoheshin në emrin e parashtruesit të kërkesës. Pala gjithashtu me dt.18.10.2024, me anë të një parashtruese të veçantë ka kërkuar sqarim për statusin e lëndës.

Mirëpo nga shënimet me të cilat disponon AKP, është konstatuar se parashtruesi i kërkesës me 20.11.2020, kishte lidhur kontratën Noteriale Ref. LRP 13020/2020, për ndërtim të përbashkët, rregullimin e raporteve pronësore dhe kalimin e kushtëzuar të pronësisë së paluajtshmërisë në investitorin

Në nenin 4, të kontratës Noteriale për ndërtim të përbashkët, është përcaktuar se “Palët në këtë kontratë dakordohen se, vetëm pasi që Investitori të pajiset me Kushte e ndërtimit për paluajtshmërit e destinuar për ndërtim me këtë Kontratën, pronësia mbi paluajtshmërin ashtu si e njëjta është përshkruara në nenin 2 më lartë në kontratë, bartet dhe regjistrohet në regjistrin kadastral në pronësi të investitorit, gjegjësisht të

SH.P.K ashtu që këtë qëllim Pronari i tokës e autorizon Investitorin që i njëjti edhe pa praninë e pronarit të tokës të beje udhëheqjen e të gjitha procedurave administrative pran organeve kadastrale komunale me qëllim të regjistrimit të paluajtshmërisë së lartpërmendur në emrin e vetëm të





Mbi bazën e kësaj kontrate si dhe kontratave tjera të lidhura me pronarët privat, investitori “  
ka bërë bashkimin/shkrirjen e më shumë se 12 parcelave private dhe është krijuar P-71914050-01836-0, me sipërfaqe prej 56.49 ari e cila evidentohet në emrin e Investitorit “

Ky fakt tregon se pala \_\_\_\_\_, si ish pronar i parcelës e cila kufizohet me parcelën e NSh-së, nuk ka më legjitimitet aktive të palës për të kërkuar blerjen e parcelës në pronësi të NSh-së.

Pretendimi i palës \_\_\_\_\_ se parcela e tij kufizohet me pronën e NSh-së nuk mund të shërbej si argument për aprovimin e kërkesës së tij. Përkundrazi, bazuar nga vizita në teren e që shihet edhe nga Harta Tematike, konstatohet se shtëpia e parashtruesit është shumë larg nga parcela e NSh-së, e për më tepër, shitja direkte bëhet vetëm përjashtimit në kushte të veçanta të përcaktuar me neni 4 të Rregullores për Shitje Direkte. Parimisht të gjitha pronat kufizohen njëra me njëra me tjetrën mirëpo nuk nënkupton me automatizëm që kualifikohet për shitje direkte..


Gjatë shqyrtimit të kërkesës së palës \_\_\_\_\_ për blerjen e parcelës kadastrale, sipas evidencës me të cilën disponon DSHS-ja, për ngastrën kadastrale 00821-0, janë parashtruar edhe dy kërkesa tjera nga palët si në vijmë: \_\_\_\_\_ – pronar i parcelës kadastrale 00824-13; dhe \_\_\_\_\_ pronar i parcelës kadastrale 00824-12.


Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



  
Mentor Hyseni  
Kryesues

Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-218/20

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale 00286-2 me sipërfaqe të përgjithshme prej 640 m<sup>2</sup>, pronë e NSh-së “Kosova Export” Fushë Kosovë me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

### ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e “Kosova Export” Fushë Kosovë me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të NSh-së.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës së tij pala thekson se prona e tij kufizohet me këtë parcelë. Pala deklaroi se kërkesa e tij për blerje direkte është në përputhje me ligjet e AKP-së.

Pala në mbështetje të kërkesës pala ka dorëzuar disa matje nga gjeoportali mirëpo mungon elaborati gjeodezik për parcelën kadastrale 00821-0, së bashku me skica dhe ortofoto. Pala gjithashtu ka dorëzuar edhe certifikatën e parcelës 00825-12 e dt 02.07.2021 si dhe kopjen e planit po ashtu e të njëjtës datë.

Sipas shënimeve të Agjencisë, është konstatuar se parashtruesi i kërkesës me 01.12.2022, kishte lidhur kontratën Noteriale Ref. LRP 13268/2022, për ndërtim të përbashkët, rregullimin e raporteve pronësore dhe kalimin e kushtëzuar të pronësisë së paluajtshmërisë në investitorin “...”. Në nenin 4, të kontratës Noteriale për ndërtim të përbashkët, është përcaktuar se “Palët në këtë kontratë dakordohen se vetëm pasi që Investitori të pajiset me Kushte e ndërtimit për paluajtshmërit e destinuar për ndërtim me këtë Kontratën, pronësia mbi paluajtshmerin ashtu si e njëjta është përshkruara ne nenin 2 me larte ne kontrate, bartet dhe regjistrohet ne regjistrin kadastral në pronësi të investitorit, gjegjësisht të SH.P.K ashtu që këtë qëllim Pronari i tokës e autorizon Investitorin që i njëjti edhe pa pranin e pronarit te tokës te beje udhëheqjen e të gjitha procedurave administrative pran organeve kadastrale komunale me qëllim të regjistrimit të paluajtshmerise se lartpërmendur në emrin e vetëm te ...”

Mbi bazën e kësaj kontrate si dhe kontratave tjera të lidhura me pronarët privat, investitori “...” ka bërë bashkimin/shkrirjen dhe ka ndërtuar objektin kolektive banesore mbi parcelën të cilën dikur ishte ne pronësi te parashtruesit te kërkesës





Agjencia gjithashtu ka bërë verifikim në Agjencisë Kadastrale të Kosovës, nëse parcela kadastrale 00825-12, ekziston dhe nga verifikimi del se kjo parcelë tashmë nuk ekziston për faktin se është bërë bashkimi i parcelave për qellim ndërtimit.

Ky fakt tregon se pala \_\_\_\_\_ si ish pronar i parcelës e cila kufizohet me parcelën e NSh-së, nuk ka më legjitimitet aktive të palës për të kërkuar blerjen e parcelës në pronësi të NSh-së.

Pretendimi i palës \_\_\_\_\_ se parcela e tij kufizohet me pronën e NSh-së nuk mund të shërbej si argument për aprovimin e kërkesës së tij. Përkundrazi, bazuar nga vizita në teren e që shihet edhe nga Harta Tematike, konstatohet se shtëpia e parashtruesit është shumë larg nga parcela e NSh-së, e për më tepër, shitja direkte behet vetëm përjashtimit në kushte te veçanta të përcaktuar me neni 4 të Rregullores për Shitje Direkte. Parimisht të gjitha pronat kufizohen njëra me njëra me tjetrën mirëpo nuk nënkupton me automatizëm që kualifikohet për shitje direkte.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



  
\_\_\_\_\_  
**Mentor Hyseni**  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-218/21

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 146 m<sup>2</sup> pjesë e parcelës kadastrale P. 827-10 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1900 m<sup>2</sup> ZK Matiçan, pronë e NSh KBI Kosova Export – Ratar në Prishtinë me parashtruesin NP nga Lipjani.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Kosova Export – Ratar në Prishtinë me parashtruesin NP nga Lipjani.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës së tij në kërkesën e bërë në vitin 2018 dhe të plotësuar me ekspertizë gjeodezike ne vitin 2021 ka theksuar se me qenë se parcela 827-10 është pronë e NSh-së nën menaxhimin e AKP-së dhe si e tillë bënë pjesë sipas Planit Rregullues ne pjesën Prishtina e Re-Zona Qendër në kuadër te bllokut urban A19 sipas palës nga Komuna e Prishtinës gjate shqyrtimit te dokumentacionit është kërkuar që një pjesë e ngastrës 827-10 te përfshihet ne zgjidhjen urbane për të mundur te vazhdohet me procedurën e marrjes se lejes ndërtimore.

Me datën 17.03.2021 pala ka plotësuar kërkesën fillestare duke paraqitur ekspertizën gjeodezike duke dhënë shpjegime tjera lidhur me kërkesën e tij.

Sipas kësaj ekspertize gjeodezike, pjesa e parcelës 827-10 me sipërfaqe prej 146 m<sup>2</sup> e cila është objekt i trajtimit shtrihet në kuadër të bllokut A19 te tërësisë hapësinore "A" te Planit Rregullues "Prishtina e Re -Zona Qendër", konkretisht se bashku me parcelat kadastrale tjera te përshkruara ne ekspertizën gjeodezike, dhe gjithashtu edhe pjesë nga parcela 1411-0 e cila do te trajtohet përmes këmbimit te pronave te gjitha këto në zonën kadastrale Matiçan janë matur në terren sipas vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore te lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Parcela e cila është objekt i kërkesës gjendet në zonën kadastrale Matiçan në Komunën e Prishtinës, zonë e cila aktualisht karakterizohet me aktivitetet të ndërtimeve të larta banesore.

Sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve te gjeoportalit te pjesa e parcelës prej 146 m<sup>2</sup> e cila është objekt i kërkesës nuk ka ndërtim, mirëpo në tërësinë e saj ka nderime konkretisht shtëpi te ndërtuara për te cilat nuk ka kërkesa në DShD. Parcela ka qasje në rrugë dhe është kufijte me parcelën 1778-0 e cila është ne bashkëpronësi ku është duke u ndërtuar kompleksi banesor i kompanisë ne fjalë.






AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se pasi që nuk ka ndërtim dhe parcela e NSh-së ka qasje në rrugë nuk ka bazë të mjaftueshme për inicimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



**Mentor Hyseni**  
**Kryesues**  
**Bordi i Drejtorëve**  
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**



Nr. Ref. BD-218/22

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale 01822-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2157 m<sup>2</sup> ZK Prishtinë. pronë e NSh KBI Kosova Export – Ratar me parashtruesin \_\_\_\_\_ nga Prishtina.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Kosova Export – Ratar me parashtruesin \_\_\_\_\_ nga Prishtina.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar në faktin se aktualisht është duke ndërtuar komplekse banimi/afarist në Veternik-Prishtina e re zona Perëndim, dhe se aty ndodhet një parcelë me nr. të ngastrës kadastrale 01822-0 pronë e KBI Kosova Export.

Tutje pala ka deklaruar se kjo parcelë është e rrethuar nga 11 parcela tjera private, dhe se me qenë se me të gjithë pronarët e parcelave për rreth ka kontratë për ndërtime të përbashkëta pala ka shprehur interesimin që ta blej përmes shitjes direkte pasi që e njëjta është ne mesin e këtyre pronave private dhe nuk ka qasje ne rrugë. Sipas palës parcela në fjalë shtrihet në pjesë të ashtuquajtura “Bllloqe Ndërtimore” në kuadër të Planit Urbanistik “Prishtina e Re” dhe paraqet problem për realizimin e projektit.

Në anën tjetër, Agjencia me datën 02.04.2024 dhe 02.05.2024 ka pranuar një shkresë informuese nga dy persona fizik \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ përmes së cilës kanë theksuar se ngastrën kadastrale 01822-0 (objekt kërkesë nga Prime Group) me sipërfaqe prej 2157m<sup>2</sup> ZK Prishtinë janë blerë në bazë të Marrëveshjes me shkrim që në vitin 2011 prej shitësve me pronësi faktike dhe juridike \_\_\_\_\_ bazë të Aktgjykimit C.nr.1908/03 te datës 19.12.2006 i cili aktgjykim sipas tyre është bërë i formës së prerë me datë 23.07.2017, dhe se marrëdhëniet kontraktuale dhe përmbushja e detyrimeve ndaj blerësve për çmimin janë vërtetuar përmes deklaratave noteriale të shitësve të lartpërmendur.

Tutje këta persona krahas informimit kanë kërkuar nga AKP që lidhur me këtë parcelë të mos ndërmarrin asnjë veprim lidhur me shitjen pasi që sipas tyre janë pronar faktik të saj. Parcela gjendet në zonën kadastrale në Prishtinë në Komunën e Prishtinës, konkretisht në Veternik (Prishtina e Re) cila aktualisht karakterizohet me aktivitetet të ndërtimeve të larta banesore. Në parcelë nuk ka ndërtim.





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

AKP kishte tenderuar këtë parcelë në SHAL 46 me datë 15 prill 2019 mirëpo pas vendosjes së Masës së Sigurisë nga DHPGJSK është dashur ta largoj nga vala  
Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte duke qenë se parcela nuk ka ndërtim dhe se fillimisht ka qenë pjesë e tenderit publik për shitje dhe e njëjta planifikohet të tenderohet përsëri.. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



Mentor Hyseni  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-218/23

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 shkurt 2025 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale K72-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 58651 m<sup>2</sup> ZK Gjakovë Jashtë Qytet, pronë e NSh Ferma e Shpezëve – Ereniku nga Gjakova.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

## ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Ferma e Shpezëve – Ereniku me parashtruesin nga Gjakova.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të NSh.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës së tij pala kompania Konsoni SHPK e përfaqësuar nga është kompani vendore e cila merret me kultivimin e shpezëve/pulave dhe shitjen e produkteve të mishit dhe vezëve të pulës dhe kërkon që të blejë përmes shitjes direkte ngastrës kadastrale së sipërcekur dhe qëllimi i kërkesës është planifikimi për zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit biznesor.

Pala në mbështetje të kërkesës së tij ka paraqitur ekspertizën gjeodezike, në bazë të së cilës ka elaboruar pretendimet e tij lidhur me ngastrën e cila është objekt i kërkesës. Rrjedhimisht në këtë ekspertizë është theksuar se parcela K72-0 nuk paraqet ndonjë kompleks bujqësorë, sepse është sipërfaqe e ngjitur me kompleksin e Fermës së Shpezëve "Konsoni" (ngastra K183-0) e gjë që e njëjta është privatizuar nga parashtruesi i kërkesës dhe si pasoje e këtyre rrethanave, pala konsideron se të drejtat pronësore mbi ngastrën K72-0 ZK Gjakovë-Jashtë Qytet nuk mund të bartet të palët e treta përmes tenderit publik sepse prona në tërësi kufizohet me pronën e tij private. Tutje pala ka theksuar se që nga viti 1999 është kujdesur për këtë parcelë sepse po të mos kujdesej ai e njëjta do të shndërrohej ne një deponi mbeturinash.

Sipas ekspertizës gjeodezike parcela K72-0 kufizohet nga ana veriore ne ngastrën K58-0 e cila evidentohet në emër te PSH KBI Ereniku, nga na lindore me ngastrën K183-0 e cila evidentohet ne emër te Konsoni-M SHPK, nga ana jugore K263-0 e cila njëkohësisht është rrugë publike e komasacionit dhe nga ana perëndimore me ngastrën K63-0 e cila evidentohet në emër te PSH KBI Ereniku

Bordi konstatoi se parcela që është objekt i kërkesës gjendet në ZK në Gjakovë-Jashtë Qytet në Komunën e Gjakovës dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme biznesi dhe atë bujqësore. Në pronë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit shihet se nuk ka ndërtim (përveç se ne një pjese te saj është vendosur peshorja për nevoja te kompanisë) dhe se e njëjta ka qasje ne rrugë, gjë e cila është përmendur edhe në ekspertizën gjeodezike te dorëzuar nga vet parashtruesi i kërkesës.





Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se pasi që nuk ka ndërtim dhe parcela e NSh-së ka qasje në rrugë nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte pasi që në pronën në fjalë nuk ka ndërtim. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 shkurt 2025.



**Menjtor Hyseni**  
Kryesues

X **Bordi i Drejtorëve**  
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**